



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Dt.06.01.2010, Nr 031-119

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës të dt.21.05.2008 në pajtim me procedurat ligjore, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, përkatësisht të nenit 79 rreth detyrave dhe përgjegjësisë të Drejtorisë Komunale për Arsim, Drejtori i DKA-së nxjerrë këtë:

RREGULLORE E PUNËS
për mësimdhënësit e institucioneve arsimore

1. Respektimi i Ligjshmërisë dhe shkresave të tjera zyrtare të MASHT-it dhe DKA-së.
2. Respektimi dhe kryerja me kohë e saktë e detyrave ndaj institucionit arsimor.
3. Respektimi i Orarit mësimor që e përpilon Drejtoria e Shkollës përkatëse.
4. Respektimi me precizitet i Orarit të zilës shkollore për orën mësimore.
5. Respektimi i detyrave që i cakton Drejtori i Shkollës përkatëse.
6. Respektimi dhe konstruktiviteti gjatë të gjitha aktiviteteve të Shkollës përkatëse.
7. Respektimi i orarit dhe konstruktiviteti në mbledhjen e aktivitetit përkatës komunal.
8. Zbatimi i plan-programeve të MASHT-it dhe zbatimi i reformave në arsim.
9. Vlerësimi sistematik i nxënësve sipas reformave arsimore dhe sa më objektiv.
10. Plotësimi dhe përkujdesja për dokumentet pedagogjike të Shkollës përkatëse.
11. Bashkëpunimi dhe ruajtja e çështjeve konfidenciale të nxënësve dhe Shkollës.
12. Organizimi dhe menaxhimi efikas i orës mësimore.
13. Aplikimi i Fletorës së Punës për përgatitjen e orës mësimore.
14. Aplikimi i Formularit të DKA-së në rast të çdo mungese në orarin e punës.
15. Mbajtja e kujdestarisë ditore sipas orarit të Shkollës përkatëse.
16. Përkujdesja dhe menaxhimi me mjetet e konkretizimit të institucionit arsimor.

Vërejtje: Për moszbatimin e kësaj rregullore, do të merren masa administrative dhe financiare në pajtim me ligjet në fuqi.

Drenas,
më 06.01.2010



Drejtori i DKA-së:
Arsim Mehmeti, prof.